REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 75/22
Datë/Datum. 29.03.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.75/ 22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 4 i "Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave" , si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020,me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE "VLERA" SH.P.K. me seli në Shtime , për aktivitetin me titull "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me Nr. prokurimi " 70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK - Spitali Regjional - Prizren , Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 29 Mars 2022 mori ketë :

VENDIM

I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE "VLERA" SH.P.K. me seli në Shtime për aktivitetin me titull "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me Nr. prokurimi " 70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional - Prizren.

II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Spitali Regjional - Prizren që të vazhdoj më

tutje me aktivitetin e prokurimit me titull "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me Nr. prokurimi " 70010-22-851-2-2-1"(përkitazi me këtë ankese nëse nuk ka ankese tjetër).

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 28.03.2022 , ka pranuar ankesë nga OE VLERA" SH.P.K. me seli në Shtime për aktivitetin me titull "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me Nr. prokurimi " 70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional - Prizren, ankesë kjo e protokolluar me numër të protokollit 75/2022.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se për aktivitetin e prokurimit " Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit" me Nr. prokurimi " 70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional - Prizren AK me datën 21.02.2022 , ka publikuar Njoftimin për kontratë.

Me datën 25.02.2022 ka publikuar Formulari Standard për korrigjim të gabimeve në Njoftimin e Publikuar.

Hapja e ofertave është planifikuar të jete me dt.18.03.2022 në ora 12:00h.

Kërkesa për rishqyrtim nga OE- ankues është dërguar tek AK datë : 13.03.2022 në ora 22.38h e që realisht numërohet si dt.14.03.2022 (katër ditë para hapjes së ofertave).

Autoriteti kontraktues Spitali Regjional i Prizrenit me datën dt.16.03.2022 , merr vendim me të cilin e refuzon kërkesën për rishqyrtim .

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se nga provat e prezantuara vërehet se OE ankues ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sepse afati i fundit për dorëzim të ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë ka qene data 18.03.2022, kurse OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë : 13.03.2022 në ora 22.38h e që realisht numërohet si dt.14.03.2022 (katër dite para hapjes së ofertave).

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se paragrafin 3 pika 3.1 e nenit 108/A te Ligjit për Prokurim Publik dhe paragrafi 4.1 pika (a) e nenit 4 te Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon:

3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë **(5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues

4.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

*a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë **(5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.***

Prandaj duke pas për bazë dispozitën e lartcekur, Organi Shqyrtues si Prokurimit konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: "VLERA" SH.P.K. me seli në Shtime e datës :28.03.2022 me numër të Protokollit 75/2022, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi kërkesën për

rishqyrtim e ka parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4 i "Rregullave Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Spitali Regjional i Prizrenit

1x1 OE "VLERA" SH.P.K. me seli në Shtime

1x1 Arhivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së